



Duke u mbështetur në nenin 40 paragrafi 2 nën pikën e) të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale, Nr.03/L-040, si dhe nenin 8 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Nr.04/L-144 dhe nenit 2 të Rregullores së QRK, Nr.23/2013 për caktimin e procedurave të dhëies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 40 alineja 2 nën pikën e pestë të Statutit të Komunës së Klinës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e X -të të rregullt, të mbajtur më 26.11.2015, mori këtë:

V E N D I M

Për

Zëvendësimin e një anëtari të Komisionit për vlerësim të ofertave për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës me anëtar të ri

I

Miratohet Vendimi për zëvendësimin e anëtarit Agron Gashi me anëtarin e ri, Elbasan Raci, në Komisionin për vlerësim të ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

II

Komisioni si në pikën 1 të këtij Vendimi ka përbërjen prej 7 anëtarëve siç vijon:

1. Pjetër Coli
2. Enver Gashi
3. Lorenc Marleku
4. Esat Raci
5. Enver Marmullaku
6. Baki Gashi
7. Elbasan Raci

III

Komisioni punon konform dispozitave ligjore në fuqi, si dhe Statutit të Komunës së Klinës dhe rregulloreve komunale.

IV

Vendimi është i plotfuqishëm me miratimin në Kuvendin e Komunës si dhe pas procedimit si në nenin 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-5924 2015
Klinë, më, 26.11.2015



Kryesuesi,
Dr. Haxhi Ibishi